

VENDIM
Nr.44, datë 21.7.2006

**PËR MOSPRANIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË GSA SHPK PËR AKTIVITETIN E
EKSPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 germa d; 15, pika 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, me ndryshimet përkatëse, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, neni 12 pika 2, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.7.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria Grupi i Sistemeve Automatike (GSA sh.p.k.) për marrje të licencës për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike, konstatoi se nga të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet e mësipërme, GSA sh.p.k. nuk i ka plotësuar tërësisht ato, si dhe nuk ka dërguar informacionin shtesë të kërkuar nga ERE.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e aplikimit të shoqërisë GSA sh.p.k. për licensë për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta